



Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë / /2016

TIRANE

TIRANE

“Deklarimin e pavlefshëm pjesërisht të titullit ekzekutiv Vendimit Nr.70, datë 11.03.2008, të Komisionit të Shërbimit Civil, përsa I përket detyrimit të pagimit të pages për periudhën kohore 25.10.2007 deri në datë 31.12.2013, në vlerën 7.848.003 Lekë.

Shfuqizimin e Vendimit Nr.5784/6 Prot, datë 09.10.2007 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme për marrje mase disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” ndaj ankuesit sit ë pabazuar në ligj e në prova.

Kthimin e ankuesit në Detyrën e mëparshme si Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme.

Detyrimin e Ministrisë së Brendshme për pagimin e pages së ankuesit që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në zbatimin e këtij vendimi”.

Për të bërë të mundur ekzekutimin e detyrimeve të vendosura në ngarkim të Ministrisë së Brendshme, ankuesi shprehet se në vitin 2013, ka kërkuar pranë Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat, Shoqëria Përmarimore “Prestige Bailiff Services” Sh.p.k., vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv të lartpërmendur dhe se, është bërë e mundur vjelja e detyrimit në të holla pjesërisht.

Referuar faktit, se, Vendimi Nr.70, datë 11.03.2008, i Komisionit të Shërbimit Civil, ka marrë formë të prerë me rastin e lënies në fuqi të tij prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, me Vendimin Nr. 23, datë 23.02.2009, si dhe ndryshimit të tij me Vendimin Gjyqësor të formës së prerë, nr. 11045, datë 17.11.2014, Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, lënë në fuqi prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, me Vendimin Nr. 302, datë 27.04.2016, konstatojmë se ekzekutimi i detyrimeve nuk është kryer dhe nuk kryhet në një afat të arsyeshëm.

Ky qëndrim i mbajtur në përmbushjen e detyrimeve të vendosura, nuk vjen në përputhje me parashikimet e nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*, apo nenin 451/a të K.Pr.C, se : *“Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera...”* dhe as me parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e Organeve të Administratës Publike, të sanksionuara në K.Pr.A. dhe të detyrueshme në kuptim dhe zbatim të këtij Kodi.

Asnjë argument i përdorur nga administrata publike nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e asaj të drejte që shtetasi e ka fituar në rrugë gjyqësore. Kështu, në vendimin e datës 18.11.2004 të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, pas shqyrtimit të të parës çështje ankimore shqiptare, të ushtruar nga kreditori, firma e ndërtimit “Qufaj” sh.p.k, për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia, Tiranë, nënvizohet se : *“Asgjë, as mungesa e fondeve nga ana e autoriteteve nuk e justifikon mos ekzekutimin e nje vendimi gjyqësor”*.

Ka qënë dhe është detyrim për Ministrinë e Punëve të Brendshme, marrja e masave për përmbushjen e detyrimeve, sikurse përcaktuar në dispozitivin e titullit ekzekutiv të sipërcituar, dhe sikurse kërkuar nga ankuesi pranë Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat. Në mospërputhje me parimin e ligjshmërisë, të sanksionuar në K.Pr.A. nuk është bërë dhe nuk bëhet e mundur, ekzekutimi i detyrimeve, megjithëse Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Privat ka lajmëruar për këto detyrime të vendosura si dhe afatin ligjor për dorëzimin vullantar të tyre.

Në këtë kuadër do të vinim theksin në faktin që angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë po bëhen gjithnjë dhe më konkrete, sidomos në planin e të drejtave të njeriut,

të zbatimit të akteve juridike ndërkombëtare dhe të integrimit evropian. Do të ishte cënim i rëndë i autoritetit të shtetit, nëse ankuesi do t'i drejtohej Gjykatës së Strasburgut kundër Shtetit Shqiptar, për një të drejtë të kësaj natyre, ndërkohë që Qeveria në programin e saj e ka konsideruar problem të mprehtë dhe është angazhuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, Parlamenti Evropian në miratimin e rezolutës për Shqipërinë datë 08.07.2010, kujton autoritetet në Shqipëri se një nga kushtet e integrimit në BE është reforma në gjyqësor, përfshi zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në praktikën e saj të vazhdueshme ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor dhe zbatimi i tij në praktik do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish, pala debitore që ju përfaqësoni duhet të marrë pjesë aktivisht në ekzekutimin e detyrimeve.

Gjykata Kushtetuese Shqiptare në vendimmarrjet e saj ka pranuar se : “... *parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj*”.

Më tej, “...*ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykitimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre*”.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike*”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen*”,

REKOMANDOJME

Marrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit Nr.70, datë 11.03.2008, të KSHC, ndryshuar me Vendimin Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 11045 datë 17.11.2014, të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, në favor të gjyqfituesit A.P.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)